



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0159
Data e Vendimit: 08.03.2024

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092 (LPP) pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik OE “T - Consulting d.o.o.” Sarajevo, ushtruar kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH” me numër të prokurimit 206-23-13309-1-1-1, iniciuar nga Ministria e Shëndetësisë, në cilësinë e autoriteti kontraktues, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit, me 08.03.2024, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si e pa afatshme, ankesa e operatorit ekonomik “T - Consulting d.o.o.” Sarajevo, e datës 23.02.2024, numër protokolli 2024/0159, e parashtruar kundër kriterëve të dosjes së tenderit, të publikuara nga Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e autoritetit kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH” me numër të prokurimit 206-23-13309-1-1-1.

II. Ministria e Shëndetësisë, ka të drejtë që nga cilësia e autoritetit kontraktues të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit të cituar si në paragrafin 1, të dispozitivit të këtij vendimi, me kusht nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

III. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara në emrin e tarifës ankimore, në emër dhe për llogari të Ankuesit i cili në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh duhet të paraqes kërkesë për kthimin e këtyre mjeteve, në të kundërtën të njëjtat konfiskohen dhe mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Me 29.11.2023, Ministria e Shëndetësisë, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH” numër prokurimi 206-23-13309-1-1-1, sipas të cilit dita e fundit e afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë data 01.02.2024.

Me 25.01.2024, autoritetit kontraktues me të dhëna si më sipër, ka publikuar Njoftimin për korigjimin e gabimeve (Formulari standard B54), sipas të cilit afati i fundit për dorëzimin e ofertave është caktuar data 15.02.2024.

Me 13.02.2024, autoritetit kontraktues me të dhëna si më sipër, sërish e ka publikuar Njoftimin për korigjimin e gabimeve, sipas të cilit afati i fundit për dorëzimin e ofertave është caktuar në këtë rast data 26.02.2024.

Me 20.02.2024, Operatori Ekonomik “T - Consulting d.o.o.” Sarajevo, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim, e cila është hedhur poshtë si e jashtë afatshme me Vendimin e autoritetit kontraktues, të datë 21.02.2024.

Me 23.02.2024, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar (në sistemin elektronik) ankesën e operatorit ekonomik “T - Consulting d.o.o.” Sarajevo, e cila është parashtruar kundër kriterëve të dosjes së tenderit, të cilat janë publikuar sipas Njoftimin për kontratë, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë në cilësinë e autoritetit kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH” me numër të prokurimit 206-23-13309-1-1-1.

Nga shkresat e kësaj lënde konstatohet se Njoftimi për kontratë, përkitazi me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH” me numër prokurimi 206-23-13309-1-1-12-1-1, i cili është iniciuar nga Ministria e Shëndetësisë, është publikuar (në sistemin e-prokurimi) me 29.11.2023, përderisa afati i fundit për praninë të tenderëve ishte data caktuar 26.02.2024. Sikurse është shpjeguar dhe si më sipër (*Faktet dhe rrethanat procedurale*), tani ankuesi, me 20.02.2024 kishte bërë kërkesë për rishqyrtim e cila është hedhur poshtë si e jashtë afatshme me Vendimin e autoritetit kontraktues të datës 21.02.2024.

Në të vërtetë, në pajtim me paragrafin 3.1 të nenit 108/A, të LPP-së, çdo palë e pakënaqur ka të drejtë që ndaj një vendimi dhe/ose veprimeve të autoritetit kontraktues, përfshirë natyrisht dhe kriteret e publikuar për një dosje të tenderit, sikurse në këtë rast, të parashtror kërkesë për rishqyrtim. Po ashtu, në kuptim të 109 të LPP, çdo palë e pakënaqur me vendimin e një autoriteti kontraktues ka të drejtë që ndaj një vendimi të autoritetit kontraktues, të ushtroj ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit, vetëm pas udhëheqjes së procedurës paraprake në nivel të AK, sikurse kërkohet me kjo me dispozitën e cituar si më sipër, të nenit 108/A, të LPP.

Në këtë rast duhet theksuar se sipas paragrafit 3.1 të nenit 108/A, të LPP, parashihet se operatori ekonomik ka të drejtë të ushtroj kërkesë për shqyrtim, e cila i paraqitet autoritetit përkatës kontraktues, cituar “..në qoftë se shkëlja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave”. Po ashtu edhe neni 60.1 pika a) i Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, parasheh se, cituar

“Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0)”. Mirëpo Rregullorja e cituar si më sipër, përcakton fare qartë se ky afat nuk aplikohet në rastet kur autoriteti kontraktues bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave, pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas nenit 63.1.1 të kësaj rregulloreje...”.

Andaj nga provat e prezantuara dhe rrjedha e këtij aktiviteti të prokurimit konstatohet se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 23.02.2024, nga OE “T - Consulting d.o.o.” Sarajevo, për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër, nuk është parashtruar në pajtim me nenin 108/A të LPP-së dhe nenin 60 par.1 të Rregullores për Prokurim Publik, andaj e njëjta mbi këtë bazë hedhet e palejuar.

OSHP gjithnjë nisat nga rregullat, zgjidhjet dhe parimet e LPP sipas të cilit secili AK ushtron pavarësinë e tij/sajë në kuptim të nenit 8 dhe 9 lidhur me planifikimin e prokurimit dhe parashikimin e nevojave, kurse kriteret e paraparë duhet ta garantojnë barazinë e operatorëve ekonomik sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 7 dhe 104 të LPP, sepse dosja e tenderit cila duhet të përpilohet në kuptim të nenit 27, lidhur me nenin 28, përbën dokumentin kyç të prokurimit publik, si për operatorët ekonomik ashtu edhe për vet autoritetin kontraktues.

Po ashtu sipas nenit 51 të LPP, parashihet shprehimisht se të gjithë kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për ti përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e ftesës për tenderim. Dhe në asnjë rast, autoriteti kontraktues *nuk duhet* të përfshijë, saktësojë ose përdorë kritere të përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji.

Prandaj në kontekstin e shpjegimeve si më sipër, Ministria e Shëndetësisë, ka të drejtë të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit, i përshkruar si më sipër por gjithnjë nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit. Mirëpo, pavarësisht se ankesa në rastin konkret hedhet si e palejuar, Organi Shqyrtues i Prokurimit i kujton autoritetit kontraktues, respektivisht Ministrisë së Shëndetësisë në këtë rast, se në pajtim me nenin 70 të LPP, sa i përket kërkesave për lidhur me standardet për sigurimin e cilësisë, autoriteti kontraktues do t’i pranojë certifikatat e barasvlershme të lëshuara nga cilido organ certifikues pavarësisht nga vendi, nëse organi i tillë pranohet nga një shtet anëtar i BE-së. Andaj autoriteti kontraktues është i obliguar të veproj në harmoni me të plotë me kërkesat e parashikuar shprehimisht me dispozitat nga nenet 1,6,7, 27,28,51,59,60, 69 të LPP.

Duke qenë se ankuesi me rastin e parashtrimt të ankesës ka paguar tarifë, konform nenit 31, par 4 të Rregullores së Punës së OSHP-së, e njëjta i kthehet ankues, mirëpo nga i njëjti kërkohet të paraqes kërkesën për kthim të mjeteve brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve sipas nenit 31 par 6 të rregullores së cituar më lartë.

Bazuar në të lartcekurat dhe bazuar në nenit 98, 99 dhe 105 të LPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, pop ala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale – Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga dara e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - T - Consulting d.o.o. Sarajevo**
- Arkivës së OSHP-së: